



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
20.03.2024

Me datë 20.03.2024, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Uarda Gjekaj, Hilmi Lakti, Bledianë Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Armela Brahimi, Hedije Nasa, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Izmira Rusi, Joniz Osmanagaj, Irena Shala, Artan Haxhi, Gjenarin Kapçari, Irma Kopliku, Elis Doci, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Jetmira Rraboshta, Ervin Ibrahim, Ardita Spahija, Samed Bushati, Suada Kopshti, Gloria Shllaku Muharrem Shkja, Amina Lici, Plarent Anamali.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit Z.Oltion Luli

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2024".
2. Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shkurt 2024".
3. Pr/ Vendim: "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të bashkisë së Shkodrës për vitet 2025-2027".
4. Pr/ Vendim: "Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2023 të Bashkisë Shkodër".
5. Raportim vjetor i veprimtarisë së Këshillit bashkiak për vitin 2023.
6. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Përpara se të vijohet me votimin e rendit të ditës, fjalën e merr **Z.Bjanku**, i cili thotë se grupi i tyre ka paraqitur me datë 08.02.2024 siç e parashikon edhe vete rregullorja, pranë Këshillit Bashkiak një kërkesë për interpelancë me Kryetarin e bashkisë. Ai shton se kërkesa e tyre deri tani nuk është marr parasysh edhe pse ka kaluar një muaj e gjysëm. Kalimi i kësaj kërkesë si pikë në rendin e ditës së mbledhjes së sotme është bërë me votim në kryesinë e këtij këshilli, gjë kjo që nuk ka asnjë mbështetje ligjore, duke cituar këtu nenin 74 të

rregullores. Ai pretendon që kjo kërkesë duhet respektuar dhe duhet të marrë përgjigje në mbledhje të Këshillit bashkiak, brenda dy muajve.

Përgjigjet **Z.Luli** duke sqaruar se kërkesa në fjalë është trajtuar në bazë të ligjit 139. Objekti i kërkesës ka të bëjë me largimet nga puna të disa nëpunësve, tagër dhe kompetencë kjo krejtësisht e Kryetarit të bashkisë, duke cituar konkretisht ligjin 139/2015.

Vendimi për kalimin e kërkesës në mbledhjen e këshillit i takon kryesisë dhe meqënëse nuk ka patur mirëkuptim është kryer me votim.

Përsëri fjala për **Z.Bjanku** duke thënë se këtë sqarim ato e presin nga Kryetari i bashkisë duke qënë se kërkesa për interpelancë është një e drejtë legjitime e tyre.

Po ashtu edhe **Znj.Shkrela** ndan të njëjtin mendim, duke u shprehur se kërkesa e tyre duhet të trajtohet brenda afat ligjor prej dy muajsh. Kryetari i bashkisë duhet të bëjë interpence dhe të sqarojë arsyet e largimeve nga puna.

Fjalën e merr **Znj.Petani** duke thënë se Kryetarit të bashkisë nuk i duhet kërkuar llogari për praninë e tij në mbledhje dhe as për kompetencat e tij.

Z.Sokoli merr fjalën dhe shprehet po ashtu që këshilltarët nuk mund të kërkojnë sqarime lidhur me shkarkimet e bëra nga Kryetari i bashkisë, duke qënë se kjo është një e drejtë dhe tagër që i takon vetëm atij.

Znj.Nika kërkon që të vijohet me votimin e rendit të ditës, pasi me diskutimet po dilet jashtë çështjeve që duhet të trajtohen në këtë mbledhje.

Edhe **Z.Shkjau** thotë se çështja e shkarkimeve nga puna nuk duhet parë politikisht por ai mendon që kërkesa e grupit të BF-së duhet t'i kalojë Kryetarit të bashkisë dhe duhet të vendosë ai nëse do ta marr në konsideratë.

Znj.Shala kërkon përsëri kalimin e kërkesës së tyre në Këshill konform rregullores. Në kryesi vendoset vetëm nëse kjo interpelancë do bëhet me diskum apo jo. Kjo çështje me kaq rëndësi, shton ajo nuk duhet të kthehet në precedent.

Fjalën e merr **Znj.Gjekaj** duke thënë se edhe nëse Kryetari do ishte present, nuk do kishte asnjë ndryshim pasi është vetëm gjykata ajo që vendos nëse shkarkimet janë të drejta apo jo.

Hidhet në votim rendi i ditës, ku rezultojnë **25** vota Pro, **12** Kundër, **0** Abstenim.

**Grupi i Kualicionit "Bashkë Fitojmë" largohet nga salla.*

Vijohet me pikën e parë të rendit të ditës: Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2024".

Dhe me pikën e dytë të rendit të ditës: Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shkurt 2024".

Relaton për të dy pr/vendimet **Z.Malocaj**, drejtor në drejtorinë e ndihmës ekonomike në Bashkinë e Shkodrës sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pr/akti i parë "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2024", hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me votimin e pr/aktit i dytë "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shkurt 2024", ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Duke qënë se kourumi i domosdoshëm nuk është më prezent në sallë, Kryetari i Këshillit **Z.Luli** e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmblodhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 20.03.2024. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio (DVD).

Procesverbali përmban 3 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Zbardhi Proces verbalin:

Irma Sulishti



Sekretar

Denis LESHJA

